


Shkaqet e Vdekjeve, 2022

Tiranë, më 26 Maj 2023: Numri i vdekjeve të regjistruara në Shqipëri gjatë vitit 2022, është 23.998, duke shënuar një rënie prej 21,3 % vdekje më pak, krahasuar me vitin e kaluar. Sipas gjinisë, u regjistruan 12.921 vdekje për meshkujt dhe 11.077 vdekje për femrat.

Referuar shkakut kryesor të vdekjeve, 97,0 % e vdekjeve gjithsej të regjistruara ishin natyrale (shkaqet natyrale).

Fig.1 Vdekjet sipas shkakut kryesor, 2022 (në %),



Vdekjet nga grupsëmundja “Aparati i qarkullimit të gjakut” zë peshën më të madhe në totalin e vdekjeve të regjistruara, dhe vazhdon të jetë shkaku kryesor i vdekjeve. Në vitin 2022, më shumë se ngjysma e vdekjeve (54,5 %) kishin këtë shkak kryesor. “Sëmundjet kronike të zemrës” (42,2 %), “Sëmundjet të enëve të trurit” (22,5 %) dhe “Sëmundjet ishemike të zemrës” (22,3 %) zënë peshën më të madhe të vdekjeve në grupsëmundjen “Aparati i qarkullimit të gjakut”. Krahasuar me vitin paraardhës, vdekjet nga kjo grupsëmundje kanë shënuar rënie me 18,2 %.

Grupsëmundja “Simptoma, shenja dhe sëmundje të papërcaktuara mirë”, përbën grupin e dytë me peshën më të lartë të vdekjeve (20,3 %). Krahasuar me vitin e kaluar, janë shënuar 4,9 % më pak humbje jete. Vdekjet në grup-moshën mbi 70 vjeç përbëjnë 82,3 % të vdekjeve për këtë grupsëmundje dhe shkaku kryesor është “Vdekje nga pleqëria”.

Grupsëmundja “Tumore” përbën grupin e tretë të sëmundjeve me peshën më të madhe të vdekjeve të regjistruara, 13,5 % të vdekjeve gjithsej. Krahasuar me vitin 2021, janë regjistruar 5,7 % më pak humbje jete nga kjo grupsëmundje. “Tumore malinj të aparatit të tretjes” (36,8 %) dhe “Tumore malinj të aparatit të frymëmarrjes” (23,4 %) përbëjnë peshën më të madhe të vdekjeve në këtë grupsëmundje.

Krahasuar me vitin 2021, vdekjet nga grupsëmundja “Sëmundje të aparatit të frymëmarrjes” zë peshën kryesore në rënien gjithsej të vdekjeve të regjistruara gjatë vitit 2022.


Tab.1 Shkaqet kryesore të vdekjeve sipas grupsëmundjes, 2022

Grupsëmundjet	2022	
	numër	%
Sëmundje të aparatit të qarkullimit të gjakut	13.082	54,5
Simptoma, shenja dhe sëmundje të papërcaktuara mirë	4.868	20,3
Tumoret	3.233	13,5
Sëmundje të aparatit të frymëmarrjes	813	3,4
Dëmtime traumatike dhe helmime	718	3,0
Sëmundje të sistemit nervor qendror dhe organeve të shqisave	270	1,1
Sëmundjet endokrinë të ushqyerit	258	1,1
Sëmundje të aparatit të tretjes	234	1,0
Sëmundje të organeve urogenitale	221	0,9
Sëmundje mendore	127	0,5
Sëmundje që shfaqen në periudhën rreth lindjes (perinatale)	86	0,4
Sëmundjet të gjakut dhe të organeve formuese të gjakut	25	0,1
Sëmundje infektive e parazitare	19	0,1
Anomali të bashkëlindura	19	0,1
Ndërlkime në barrë,të lindjes dhe të periudhës së paslindjes	17	0,1
Sëmundje të sistemit të kockave dhe te kyçeve	8	0,0
Sëmundje të lëkurës dhe të indit qelizor në qelizë	0	0,0
Gjithsej	23.998	100,0

Vdekshmëria sipas gjinisë

Nga 23.998 të vdekur gjithsej, 53,8 % ishin meshkuj dhe 46,2 % ishin femra. Si te femrat dhe te meshkujt, grupsëmundja “Sëmundje të aparatit të qarkullimit të gjakut” përbën shkakun kryesor të humbjeve të jetës, përkatësisht 53,3 % meshkuj dhe 56,0 % femra. Grupsëmundja “Simptoma, shenja dhe sëmundje të papërcaktuara mirë” përbën shkakun e dytë kryesor të vdekjeve për të dyja gjinitë, ku përqindja e vdekjeve te femrat është më e lartë se te meshkujt, 23,9 % me 17,2 %. Grupsëmundja e tretë vijon “Tumore”, me përqindjen më të lartë të vdekjeve te meshkujt (15,7 %) krahasuar me femrat (10,8 %).


Fig. 2 Grupsëmundjet kryesore të vdekjeve sipas gjinisë, 2022



Vdekshmëria foshnjore

Në vitin 2022, janë regjistruar 161 vdekje foshnjore. Norma e vdekshmërisë foshnjore është 6,5 për 1.000 lindje të gjalla, përkundrejt 8,4 në vitin 2021. Shkaqet kryesore të vdekshmërisë foshnjore (nën 1 vjeç) janë “Sëmundjet që shfaqen në periudhën rreth lindjes (perinatale)” me 52,8 % dhe “Sëmundje të aparatit të qarkullimit të gjakut” me 21,1 % të vdekjeve të regjistruara.

Fig.3 Vdekshmëria foshnjore sipas shkakut kryesor, 2022 (në %)



Vdekshmëria sipas grup-moshës

Për grup-moshën 0-19 vjeç, pesha më e madhe e humbjeve të jetës lidhet me grupsëmundjet “Sëmundje që shfaqen në periudhën rreth lindjes” (29,8 %) dhe “Sëmundje të aparatit të qarkullimit të gjakut” (28,1 %).

“Sëmundje të aparatit të qarkullimit të gjakut” (31,6 %) dhe “Dëmtimet traumatike dhe helmime” (30,1 %) përbëjnë grupet me peshën më të madhe në vdekjet e shkaktuara për grup-moshën 20-44 vjeç.


Për grup-moshat 45-64, 65-79 dhe 80+ vjeç, grupi kryesor mbetet “Sëmundje të aparatit të qarkullimit të gjakut”.

Tab.2 Vdekjet sipas grupsëmundjes dhe grup-moshës, 2022 (në %)

Grupsëmundjet	Grup-mosha				
	0-19	20-44	45-64	65-79	80+
Sëmundje infektive e parazitare	0.4	0.5	0.2	0.0	0.03
Tumore	2.8	19.1	29.4	18.6	5.18
Sëmundjet endokrinë të ushqyerit	0.0	0.5	0.8	1.7	0.77
Sëmundje të gjakut dhe të organeve formuese të gjakut	0.4	0.0	0.1	0.1	0.10
Sëmundje mendore	0.0	1.0	0.5	0.5	0.59
Sëmundje të sistemit nervor qëndror dhe organeve të shqisave	2.1	3.3	1.3	1.5	0.69
Sëmundje të aparatit të qarkullimit të gjakut	28.1	31.6	44.8	60.2	55.08
Sëmundje të aparatit të frymëmarrjes	0.7	1.5	2.6	3.9	3.41
Sëmundje të aparatit të tretjes	0.0	1.3	2.6	1.2	0.39
Sëmundje të organeve urogenitale	0.0	0.3	0.8	1.2	0.82
Ndërlikime në barrë,të lindjes dhe te periudhës së paslindjes	6.0	0.0	0.0	0.0	0.00
Sëmundje të lëkurës dhe të indit qelizor në qelizë	0.0	0.0	0.0	0.0	0.00
Sëmundje të sistemit të kockave dhe te kyçeve	0.0	0.0	0.1	0.0	0.02
Anomali të bashkëlindura	5.3	0.5	0.0	0.0	0.00
Sëmundje që shfaqen në periudhën rreth lindjes (perinatale)	29.8	0.0	0.0	0.0	0.01
Simptoma, shenja dhe sëmundje të papërcaktuara mirë	5.3	10.3	8.7	9.4	32.33
Dëmtime traumatike dhe helmime	19.3	30.1	8.2	1.7	0.57
Gjithsej	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0

Analizuar sipas shkakut të vdekjeve, grupsëmundja “Simptoma, shenja dhe sëmundje të papërcaktuara mirë” përbën shkahun kryesor të vdekjeve për grup-moshën mbi 80 vjeç (76,5 %). Në grupsëmundjen “Sëmundje të aparatit të qarkullimit të gjakut”, përafërsisht gjysma e humbjeve të jetës i përket grup-moshës mbi 80 vjeç (48,5 %). Ndërkohë, te grupsëmundja “Tumore”, përafërsisht gjysma e humbjeve të jetës i përket grup-moshës 65-79 vjeç (47,6 %).


Fig.4 Vdekjet sipas grupsëmundjeve kryesore dhe grup-moshës, 2022



Vdekshmëria sipas qarqeve

Analizuar për secilën qark, në figurën më poshtë janë paraqitur përqindjet e vdekjeve sipas grupsëmundjeve kryesore. Në vitin 2022, vdekshmëria sipas grupsëmundjeve kryesore për çdo qark ruan pothuajse të njëjtën strukturë, ku numri më i madh i vdekjeve shkaktohet nga grupsëmundja “Sëmundje të aparatit të qarkullimit të gjakut” ndjekur nga “Simptoma, shenja dhe sëmundje të papërcaktuara mirë” dhe “Tumore”.

Fig. 5 Vdekshmëria sipas grupsëmundjes dhe qarqeve, 2022 (në %)



Metodologjia

Të dhënat e shkaqeve të vdekjes

Të dhënat e vdekjeve sigurohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile sipas karakteristikave bazë demografike dhe sëmundjeve shkaktar të vdekjes. Të dhënat e shkakut të vdekjes bazohen mbi informacionin e marrë nga "skedat e vdekjeve" të plotësuara nga mjeku. Më pas, të dhënat pastrohen dhe përpunohen duke analizuar një sërë variablash si: përshkrimin me fjalë të sëmundjes, moshën dhe gjininë e personit, si dhe bëhet kodifikimi i shkakut sipas klasifikimit ndërkombëtar ICD -9.

Klasifikimi Ndërkombëtar "ICD-9" është klasifikimi ndërkombëtar i sëmundjeve, bën grupimin në mënyrë të koduar të 17 grupeve kryesore të sëmundjeve. Kodimi për shkaqet e vdekjeve bëhet nga mjeku dhe përbëjnë burimin më të plotë zyrtar statistikor të sëmundjeve që janë shkak i vdekjes.

Përkufizime

Shkaku i vdekjes është sëmundja ose simptoma që ka shkaktuar ose kontribuar në vdekje, si dhe rrethanat e aksidentit që kanë shkaktuar këto trauma (Përshkruhet në certifikatën e vdekjes).

Vdekja nënkupton zhdukjen e qëndrueshme të të gjitha shenjave të jetës në një moment të çfarëdoshëm pas një lindjeje të gjallë (ndërprerjen e funksioneve jetësore pa mundësi reanimimi). Ky përkufizim nuk përmban vdekjen fetale.

Koeficienti i Vdekjeve sipas Shkaqeve tregon numrin e vdekjeve që i atribuohen një shkakut specifik për 100 mijë banorë në një vit të dhënë.

Koeficienti i Vdekshmërisë (koeficienti bruto i vdekjeve) tregon numrin e vdekjeve për 100 mijë banorë për një vit të dhënë.

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.